**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Komuna Rahovec**
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 3150 Më / Dt. 10.08.2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr 03/L222 dhe Ligjit Nr 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet,Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, dispozitat e nenit 8,10,12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr 04/2017 mbi Kriteret , Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve nenit 74, dhe nenit 92,paragrafi 4, të statutit të komunës Nr 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirjes Publike të datës 05.07.2021 mbi organizimin e festave tradicionale kulturore në Komunën e Rahovecit të cilat janë: **Festa e vjeljes së rrushit Rahovec, Agrofesta-Krushë e madhe**, bazuar në vendimin Nr **826 të datës 05.08.2021** për formimin e Komisionit,për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për Ndarje të Subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirjes piublike, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Në përputhje me afatet,detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues të përcaktuara me Rregulloret e lartëcekura dhe vendimit të Kryetarit të Komunës dhe mbi bazën e thirjes Publike të datës 05.07.2021,Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të , ku sipas kritereve, Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues për Subvencionim këto OJQ:

**2. NR EMRAT E OJQ-VE SHUMA**

**2.1 SHOQATA HARDH FEST ....................................................37,000.00**

3.Pas kalimit të afatit ankesave dhe procedurave tjera të parapara në rregulloret e lartëcekura,Kryetari i Komunës do të lidh kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

**ARSYETIM**

Komisioni për shyrtimin dhe vlerësimin e aplkacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të,mbi bazën e thirjes publike dhe në përputhje me Rregulloret e lartëcekura,ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe mbi bazën e thirjes publike nga 1 aplikacion,kriteret i ka plotësuar vetëm një OJQ.
Në përputhje me detyrat,përgjegjësitë dhe afatet e komisionit të përcaktuara në Rregulloret e lartëcekura dhe duke vlerësuar secilin aplikacion dhe projekt të OJQ-ve, veç e veç sipas thirrjes publike të datës 05.07.2021 Nr 3404.
Nga se u tha më lartë Komisioni ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim Juridik:**Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh,pranë Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave të OJQ-ve në Komunën e Rahovecit.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizem**

---

**Datë: 10.08.2021**
**Rahovec**

**Komisioni Komunal për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirjes për aplikim me nr.prot. 3404, të datës 05.07.2021.**

Në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës Nr. 826/247/21, të datës 05.08.2021 komisoni i caktuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të organizatave dhe OJQ-ve për organizimin e festave **"Festa e vjeljes së rrushit" që do të mbahet me datë: 3, 4 dhe 5 shtator** dhe **"Agrofesta – Krushë e Madhe" që do të mbahet me datë: 20 dhe 21 Gusht**, mbi bazën e thirrjes publike në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Rahovecit".

1. Anëtarët e komisionit me datën 10.08.2021, kanë bërë verifikimin e aplikacioneve në bazë të kritereve të aplikimit, ku kanë shqyrtuar aplikacionet e aplikuesve.

2. Me datën 10.08.2021 ne ora 14:30, komisioni ka përzgjedhur përfituesin i cili i ka plotësuar kriteret e aplikimit.

3. Raporti përfundimtar i detajuar, është përpiluar me të njëjtën datë 10.08.2021 dhe ka shpallur rezultatet e përfituesve me datën 11.08.2021.